



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS MALISHEVË

Numri i lëndës: 2021:245529
Datë: 15.03.2024
Numri i dokumentit: 05459382

C.nr.1005/21

Gjykata Themelore Gjakovë-Dega e Gjykatës në Malishevë, Departamenti i Përgjithshëm/ Divizioni Civil, gjyqtari Petrit Curri në çështjen juridike kontestimore të paditëses Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike Sh.A. (KEDS) me seli në Bulevardin “Bill Klinton” nr.3, ndërtesa e Elektro-Kosovës, kati II, nr.5 Prishtinë, kundër të paditurit-tani të ndjerit N.(A.) B. nga fshati K.-Komuna e Malishevës, me objekt kontesti kompensim i dëmit material, vlera e kontestit 739.57 euro, jashtë seancës gjyqësore me datë 15.03.2024 mori këtë:

A K T V E N D I M

- I. NDËRPRITET** procedura në këtë çështje juridike kontestimore me shenjën C.nr.1005/21, sipas padisë së paditëses Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike Sh.A. (KEDS) me seli në Prishtinë, kundër të paditurit N.(A.) B. nga fshati K./Malishevë lidhur me kompensimin e dëmit material, për shkak të vdekjes së të paditurit.
- II.** Procedura e ndërprerë në këtë çështje do të vazhdohet kur trashëgimtari/trashëgimtarët e të paditurit apo kujdestari i pasurisë trashëgimore ta marrin përsipër procedurën, apo kur t’i thërrasë gjykata ta bëjnë këtë, me propozimin e palës kundërshtare.

A r s y e t i m

Paditësja Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike Sh.A. (KEDS) me seli në Prishtinë, pranë kësaj gjykate me datë 21.10.2021 ka parashtruar padi ndaj të paditurit N.(A.) B. nga fshati K./Malishevë, me objekt kontesti “Kompensim i dëmit material”, me vlerë të kontestit 739.57 €.

Gjykata përmes aktvendimit procedural C.nr.1005/21 të datës 14.02.2024, në mbështetje të dispozitës nga neni 394 të LPK-së, padinë me të gjitha shkresat e bashkangjitura ia ka dërguar të paditurit, në mënyrë që t’i ofrohet mundësia për paraqitjen e përgjigjes në padi brenda afatit prej 15 ditëve në kuptim të dispozitës nga neni 395 par.1 të LPK-së.

Me datën 22.02.2024, përmes parashtresës/njoftimit të dorëzuar në Gjykatë nga ana e personit K. B., i njëjti ka njoftuar se i padituri N.A. B. nga fshati K. ka vdekur me datë 31.08.2023. Përveç këtij njoftimi, ai duke u bazuar në dispozitat e LPK-së dhe LMD-së, ka

kërkuar nga gjykata ta ndërpres/përfundoj procedurën në këtë lëndë civile dhe ta hedhë padinë e paditësit si të pa bazuar, sepse personi i vdekur nuk ka mundësi të përgjigjet dhe të përmbushë detyrimet të cilat edhe ashtu janë të pabazuara.

Parashtresës/njoftimit në fjalë, i është bashkangjitur edhe certifikata e vdekjes, me numër reference ... dhe me numër serik V ..., e lëshuar me datë 11.12.2023, nga e cila vërtetohet se tani i ndjeri N. (A.) B. i lindur me 25.10.1954 në K., me numër personal ..., ka ndërruar jetë me datë 31.08.2023 në K..

Me rastin e vënies në dijeni të këtij fakti, gjykata iu referua dispozitës së nenit 277 pika a) të LPK-së, e cila përcakton se: *“Procesi gjyqësor ndërpritet: a) kur pala ndërgjyqëse vdes ose e humbë zotësinë procedurale, e nuk ka të caktuar përfaqësues me prokurë në gjykim”*. Bazuar në faktin se Gjukata disponon me dëshmi shkresore në drejtim të argumentimit të faktit se i padituri N. B. ka ndërruar jetë dhe një rrethanë e tillë paraqet pengesë për procedim të mëtutjeshëm në këtë çështje kontestimore, andaj në kuptim të dispozitës së lartcekur nga neni 277 pika a) të LPK-së janë plotësuar prezumimet për ndërprerjen e procedurës.

Vendosjen nga pika II e dispozitivit të këtij aktvendimi, Gjukata e mbështeti në dispozitën nga neni 280 par.1 të LPK-së, e cila përcakton se: *“Procedura që është ndërprerë për shkaqe të treguara në nenin 277 paragrafi 1 pika a)–d) të këtij ligji do të vazhdohet kur trashëgimtari, apo kujdestari i pasurisë trashëgimore, përfaqësuesi i ri ligjor, administratori i falimentimit apo pasardhësi juridik i personit juridik, e marrin përsipër procedurën apo kur i thërret gjykata ta bëjnë këtë, me propozimin e palës kundërshtare”*.

Gjukata vë në dukje se në kuptim të dispozitës nga neni 279 të LPK-së, si rezultat i ndërprerjes së kësaj procedure, rrjedhimisht ndërpriten edhe afatet për zhvillimin e veprimeve procedurale dhe gjatë kësaj kohe gjykata nuk mund kryej kurrfarë veprimesh procedurale, e po ashtu veprimet e kryera nga ndonjëra prej palëve ndërgjyqëse nuk prodhojnë kurrfarë efekti juridik ndaj palës kundërshtare, deri në momentin e vazhimit eventual të procedurës.

Andaj, në një gjendje të këtillë dhe mbi bazën e të lartcekurave, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjukata Themelore Gjakovë-Dega e Gjukatës në Malishevë
Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Civil
C.nr.1005/21, datë 15.03.2024

G j y q t a r i
P e t r i t C u r r i

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afatin prej 15 ditësh nga dita e pranimit. Ankesa i drejtohet Gjukatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.